



VENDIM

Nr. 53 Datë 03.08.2009

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, gërma “d”, dhe 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 4, gërma “g”; 5; 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.08.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k për liçensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike,

dhe Konstatoi se :

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k ka nisur me marrjen e vendimit Nr. 36, dt.07.05.2009.
- Dokumentacioni për aplikimin për liçensimin për kryerjen e aktivitetit të tregëtimit të energjisë elektrike është paraqitur i plotë konform përcaktimeve të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensoje shoqërinë “EFT Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike me afat të vlefshmerise se licenses 5 vjet.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 53 Datë 03.08.2009

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|-------------------|-------|--------|
| Bujar Nepravishta | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Shkelqim Bozgo | _____ | _____ |